



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 471, datë 25.07.2017**

**Për**

**“Vlerësimin si jashtë kompetence të ankesës së ‘Ora’ sh.a dhe përcjelljen e ankesës pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Juliana	LATIFI	Kryetare
Eduard	YPI	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtare
Leida	MATJA	Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 25.07.2017, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm: “Mbi vlerësimin e kërkesës së Shoqërisë ‘ORA’ Sh.a. “

**Bazë ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), neni 2, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 24 i Kodit të Procedurës Administrative.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe me propozim të Sekretariatit;

**VËREN SE:**

**1. PROCEDURA E NDJEKUR;**

1. Pranë Autoriteti të Konkurrencës është protokolluar me nr. 206/2 prot., datë 13.07.2017, kërkesa e shoqërisë “ORA” Sh.a., për marrje e informacioni dhe prononcim. Kjo shoqëri rezulton të jetë ankuar pranë Autoritetit të Konkurrencës edhe me shkresën nr. 206 prot., datë 22.05.2017, si dhe nga ana e AK i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 206/1 prot., datë 13.06.2017, duke sqaruar dhe arsyet e mos kompetencës së AK.

2. Në përmbledhje të pretendimeve të paraqitura edhe në formularin e ankesës së depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës kërkohet të konstatohet nëse kuorumi në procedurën e vendimmarrjes nga AMA ka qenë i rregullt apo jo dhe revokimin e saj, si një vendim që shkel ligjin për konkurrencën.

3. Autoriteti i Mediave Audiovizive është person juridik publik, i pavarur dhe që vepron në zbatim të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, duke rregulluar fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive. Dhënia e licencave dhe autorizimeve ndaj operatorëve televizivë është kompetencë administrative e AMA, e cila buron nga ligji 97/2013. Pronësia në transmetimet audio dhe audiovizive tokësore, si dhe dhënia e licencave kombëtare të transmetimit, rregullohen nga neni 62 i këtij ligji. Çdo pretendim për shkelje të normave të këtij ligji rregullohen po aty, kështu ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” është një ligj i posaçëm që rregullon fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive.

4. Pretendimi i shoqërisë “ORA” Sh.a. për konstatimin e rregullsisë së kuorumit dhe vetë procedurën e vendimmarrjes nga AMA është jashtë kompetencës të parashikuar në ligjin 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. AMA është person juridik publik i pavarur dhe kompetent lidhur me fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe është organi publik kompetent sipas ligjit. AK nuk ka kompetencë për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga AMA.

5. Pretendimi për revokimin e vendimit të AMA për shkak të shkeljes së ligjit për konkurrencën është përsëri jashtë kompetence, AK nuk mund të anulojë apo shfuqizojë vendimin e AMA sipas Kodit të Procedurave Administrative, pasi nuk është organi që ka kompetencë nxjerrjen e aktit. Ankesa e ngritur nga shoqëria “ORA” është objekt i ligjit 97/2013 si ligj i posaçëm që rregullon çështjen konkrete.

6. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se ankesa e shoqërisë “ORA” është e rregulluar me ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe për kompetencë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive që është dhe organi publik kompetent për zbatimin e këtij ligji.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 2, 24, germa d), 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar dhe nenit 24 të Kodit të Procedurave Administrative me propozim të Sekretariatit,

#### **VENDOSI:**

1. Vlerësimin si jashtë kompetence të ankesës së “ORA” sh.a dhe përcjelljen e ankesës pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.
2. Njoftimin e vendimit, shoqërisë “ORA” Sh.a.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**